UDHËZIM
Nr. 2, datë 14.2.2013

PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMITETIT SHKENCOR DHE TË PANELEVE SHKENCORE PRANË AUTORITETIT KOMBËTAR TË USHQIMIT

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe të nenit 66 të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008 "Për ushqimin", të ndryshuar

UDHËZOJ:

1. Komiteti Shkencor (më tej "Komiteti") ka për qëllim të sigurojë dhënien e mendimit shkencor në fushën e sigurisë ushqimore dhe mblidhet në funksion të këtij qëllimi sa herë që kjo i kërkohet ose me vetë iniciativën e tij.

2. Pranë Komitetit ngrihen dy panele shkencore (më tej "panelet"), përkatësisht Paneli i Rreziqeve Biologjike dhe Paneli i Rreziqeve Kimike, të ndara sipas tipologjisë së riskut të mundshëm të sigurisë ushqimore, me funksionet e përgatitjes së mendimit shkencor për çështjet konkrete për të cilat Komiteti duhet të japë mendim.

3. Paneli i Rreziqeve Biologjike ushtron funksionet e tij për çështjet që lidhen me:

- zoonozat (sëmundjet që shkaktohen nga ushqimet) BSE/TSE, mikrobiologjinë e ushqimeve, higjienën ushqimore, mbetjet e krijuara nga përpunimi i ushqimeve.

4. Paneli i Rreziqeve Kimike ushtron funksionet e tij për çështjet që lidhen me:

- kontaminantet ushqimore, mbetjet e pesticideve në produktet ushqimore, mbetjet e medikamenteve veterinare në produktet ushqimore, aditivët ushqimorë, materialet në kontakt me ushqimin.

5. Komiteti i propozon ministrit ngritjen e një paneli të ri në rast të paraqitjes së një kërkese për mendim apo të propozimit të dhënies së një mendimi shkencor me iniciativën e tij, e cila del jashtë fushës së objektit të veprimtarisë së dy paneleve të ngritura. Ngritja e paneleve të tjera shkencore bëhet me udhëzim të ministrit.

6. Komiteti dhe panelet përbëhen nga ekspertë me kualifikim të lartë akademik, mbajtës të titullit profesor ose profesor i asociuar, si dhe me arritje profesionale në fushat shkencore, të cilat lidhen me sigurinë ushqimore. Komiteti dhe panelet drejtohen nga kryetarët përkatës, të cilët bashkërendojnë aktivitetin e tyre. Komiteti ka në përbërje të tij 7 anëtarë, ndër të cilët 2 anëtarë janë kryetarët e paneleve. Panelet kanë në përbërje të tyre 6 anëtarë. Midis anëtarëve të Komitetit dhe të paneleve zgjidhet edhe kryetari i tyre. Anëtarët e Komitetit dhe të paneleve, si dhe kryetarët e tyre emërohen dhe shkarkohen me urdhër të ministrit.

7. Anëtarët e Komitetit, si dhe anëtarët e paneleve duhet të ruajnë konfidencialitetin e çështjeve të trajtuara gjatë ushtrimit të funksionit të tyre. Për këtë qëllim, me pranimin e emërimit të tyre në këto funksione, anëtarët pranojnë që të jenë objekt i rregullave të etikës dhe ruajtjes së konfidencialitetit, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për administratën shtetërore. Anëtarët në asnjë mënyrë nuk mund të delegojnë funksionet e tyre të parashikuara në këtë udhëzim.

8. Komiteti mblidhet sa herë që i kërkohet të japë një mendim shkencor ose kur Komiteti e sheh të nevojshme të japë një mendim shkencor me iniciativën e tij. Në rastin e dhënies së mendimit me iniciativën e vet Komitetit, kryetari thërret mbledhjen e Komitetit kur kjo kërkohet me shkrim nga të paktën 3 anëtarë, duke përcaktuar çështjet për të cilat thirret kjo mbledhje.

9. Në çdo rast, mbledhja thirret nga kryetari brenda 15 ditëve pas paraqitjes së kërkesës për mendim dhe njoftimi i anëtarëve duhet të bëhet të paktën 6 ditë para datës së përcaktuar për mbledhjen. Njoftimi duhet të tregojë në mënyrë të qartë dhe të detajuar çështjet për të cilat do të diskutohet. Kërkesa për të vendosur një çështje në rendin e ditës duhet të bëhet me shkrim, të paktën 4 ditë përpara datës së vendosur për mbledhjen. Rendi i ditës i përditësuar duhet t'i shpërndahet të gjithë anëtarëve, të paktën 48 orë përpara datës dhe kohës së mbledhjes.

10. Në mbledhjen e caktuar, Komiteti, gjatë shqyrtimit të kërkesës për mendim ose propozimit për dhënie mendimi shkencor me iniciativën e tij, vendos për pranimin ose refuzimin e saj.

11. Në rastin e pranimit të kërkesës për dhënie mendimi ose në rastin e dhënies së mendimit me iniciativën e tij, Komiteti me vendim e kalon çështjen për vlerësim dhe përgatitje të projektmendimit shkencor, te paneli përkatës. Afati, brenda të cilit paneli duhet të përfundojë përgatitjen e projektmendimit, si dhe të detyrave të ngarkuara nga Komiteti, përcaktohet nga ky i fundit në vendim.

12. Kur e shikon të arsyeshme, Komiteti, mund të dëgjojë, si dhe të ngarkojë me detyra edhe ekspertë të jashtëm, të cilët të plotësojnë kushtet e përcaktuara në pikën 6 për anëtarët.

13. Me marrjen e vendimit të Komitetit, kryetari i panelit organizon menjëherë mbledhjen e anëtarëve të panelit, ku cakton ndarjen e detyrave dhe koordinon punën për hartimin e projektmendimit. Projektmendimi i hartuar, nënshkruhet nga kryetari i panelit dhe anëtarët.

14. Brenda afatit të përcaktuar, paneli i paraqet Komitetit me shkrim projektmendimin e përgatitur për çështjen e ngarkuar, si dhe të gjitha rezultatet dhe dokumentacionin përkatës mbi të cilat është përgatitur ky projektmendim.

15. Kryetari i Komitetit njofton menjëherë anëtarët e Komitetit për përfundimin e përgatitjes së projektmendimit nga ana e panelit dhe e vendos atë në dispozicion për konsultim nga anëtarët. Kryetari i komitetit në të njëjtin njoftim thërret edhe mbledhjen e radhës sipas përcaktimeve të pikës 5 ku do të shqyrtohet projektmendimi i përgatitur.

16. Komiteti merr vendime vetëm për çështje, të cilat janë përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes. Mbledhja e Komitetit është e vlefshme kur janë të pranishëm të paktën 5 anëtarë. Kur në hapjen e mbledhjes nuk janë të pranishëm shumica e anëtarëve, kryetari vendos thirrjen e mbledhjes në një ditë tjetër. Mendimi shkencor miratohet me votimin në favor të ¾ të anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

17. Në rastin kur gjatë mbledhjes për shqyrtimin e projektmendimit të përgatitur nga paneli, njëri nga anëtarët mendon se është i nevojshëm një informacion më i plotë në lidhje me argumentet e përdorura për përgatitjen e projektmendimit, atëherë Komiteti shtyn mbledhjen për një ditë tjetër dhe i kërkon panelit informacion shtesë të nevojshëm për t'u paraqitur brenda një afati kohor të përcaktuar nga Komiteti.

18. Në çdo mbledhje mbahet një procesverbal, ku bëhet një përmbledhje e gjithçka u tha në mbledhje, data dhe vendi i mbledhjes, anëtarët që morën pjesë, çështjet që u diskutuan, vendimet që u morën, si dhe rezultati i votimeve.

19. Procesverbali mbahet nga sekretariati dhe duhet t'u paraqitet për miratim të gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhje, në fund të mbledhjes ose brenda 7 ditëve nga dita e mbajtjes së mbledhjes. Në rastet kur vetë Komiteti e shikon të arsyeshme dhe mbledhja është e ndarë në seanca, procesverbali miratohet menjëherë pas përfundimit të seancës përkatëse.

20. Në çdo rast, mendimi shkencor i miratuar nga Komiteti, përveç organeve, të cilat kanë drejtuar kërkesën për mendim, i dërgohet edhe ministrit.

21. Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Dokumentacionit pranë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit ndihmon dhe asiston Komitetin dhe panelet në mbarëvajtjen e funksionimit administrativ të aktivitetit të tyre në cilësinë e sekretariatit.

22. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË, USHQIMIT DHE
MBROJTJES SË KONSUMATORIT
Genc Ruli

UDHËZIM
Nr. 146, datë 18.2.2013

PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË OPERACIONEVE TEKNIKE QË KRYHEN NGA OFIÇINA (QENDRA TEKNIKE) E AUTORIZUAR E TAHOGRAFIT

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 7.1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1054, datë 22.12.2010 "Për miratimin e rregullores për pajisjet e regjistrimit në transportin rrugor", Ministri i Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministri i Financave

UDHËZOJNË:

1. Tarifat maksimale për operacionet që kryhen nga ofiçinat e autorizuara të tahografit janë në shumat si më poshtë:

1.1 Për sistemin e tahografit analog:

a) tarifa e kalibrimit	8500 lekë;
b) tarifa e inspektimit 2-vjeçar	6500 lekë;
c) tarifa e inspektimit 6-vjeçar	7800 lekë.

1.2 Për sistemin e tahografit digjital:

a) tarifa e kalibrimit fillestar	8500 lekë;
b) tarifa e inspektimit periodik (përfshirë kalibrimin)	6500 lekë;
c) tarifa për heqjen e pajisjes së regjistrimit	7800 lekë.

1.3 Tarifat e mësipërme përfshijnë instalimin e pllakës dhe vulosjen.

2. Pagesat për ndonjë punim të kryer jashtë atyre të përmendura në këtë udhëzim, janë sipas çmimeve të tregut.

3. Në tarifat e përcaktuara në këtë udhëzim është e përfshirë TVSH-ja.

4. Tarifat afishohen në çdo ofiçinë të autorizuar të tahografit.

5. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

UDHËZIM
Nr. 10, datë 25.2.2013

PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 5, DATË 30.1.2006 "PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 5, datë 30.1.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar, bëhen këto shtesa e ndryshime:

1. Në fund të pikës 2.4 "Të ardhura të përjashtuara" shtohen germat "ë" dhe "g" me këtë përmbajtje:

"ë) Përfitimet për dëmshpërblime të marra nëpërmjet vendimeve të formës së prerë të gjykatave, si dhe kompensimet e caktuara për kostot gjyqësore. Përfitimet për punonjësit e larguar nga puna, për të cilët Gjykata ka vendosur kthimin në vendet e punës dhe përfitimin e pagës deri në momentin e kthimit në punë, nuk janë objekt përjashtimi.

g) Të ardhurat e përfituara nga individët për arritjet në shkencë, sport dhe kulturë, të dhëna nga

institucionet buxhetore, sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave, që përcaktojnë masën dhe kriteret e përfitimit, të përcaktuara gjithashtu në ligjin vjetor përkatës "Për buxhetin e shtetit"."

2. Në fund të pikës 3.5 "Shpenzime të njohura", shtohet germa "d" me këtë përmbajtje:

"Bursat që u jepen nxënësve dhe studentëve nga institucionet arsimore publike dhe jopublike njihen si shpenzim i zbritshëm deri në masën e përcaktuar me vendime të Këshillit të Ministrave, me kusht që institucionet arsimore publike dhe jopublike, në fillim të vitit shkollor, të paraqesin pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, numrin dhe shumën e bursave që do të përfitohen. Tatimpaguesi paraqet pranë organeve tatimore kopje të dokumentacionit të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, të numrit dhe shumës së bursave të përfituara nga studentët apo nxënësit. Institucionet arsimore që përfitojnë nga kjo pikë duhet të jenë të akredituara nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës.".

3. Në fjalinë e fundit të pikës 3.11 "Mbartja e humbjeve", fjalët "me më shumë se 25%", zëvendësohen me fjalët "me më shumë se 50%".

4. Pika 3.13 Parapagimet (paradhëniet) paragrafi i parë ndryshon si më poshtë:

a) Tatimi mbi fitimin paguhet në formë paradhënieje, për tremujorin e parë të vitit brenda datës 30 mars për muajt janar, shkurt, mars: për tremujorin e dytë të vitit brenda datës 30 qershor për muajt prill, maj, qershor; për tremujorin e tretë të vitit brenda datës 30 shtator për muajt korrik, gusht, shtator dhe për tremujorin e katërt brenda datës 30 dhjetor për muajt tetor, nëntor, dhjetor.

b) Tatimi mbi fitimin mund të paguhet në formë paradhënieje mbi baza mujore jo më vonë se data 15 e çdo muaji.

Kështet mujore dhe tremujore të vitit ushtrimor llogariten siç përcaktohet në pikat 3.13.1, si më poshtë:

Organi tatimor, bazuar në të dhënat e deklaruara nga tatimpaguesi dhe të dhënat e bilancit kontabël dhe anekseve të tij të paraqitura nga tatimpaguesi, të korrigjuara në përputhje me rezultatet e kontrolleve të kryera pranë tatimpaguesit, përgatit njoftimin për pagesë të kësteve të parapagimit të tatimit mbi fitimin.

Njoftimi për pagesë të kësteve të parapagimit të tatimit mbi fitimin për periudhën janar-prill i njoftohet tatimpaguesit brenda datës 15 dhjetor të vitit paraardhës, ndërsa njoftimi për pagesë të kësteve të parapagimit të tatimit mbi fitimin për periudhën maj-dhjetor i njoftohet brenda datës 15 prill.

Në pikën 3.13.1 llogaritja e kësteve të parapagimeve (të paradhënieve), pikat "a", "b" dhe "c" ndryshohen me përmbajtjet e mëposhtme dhe shtohet pika "ç".

"a) për periudhën tatimore të vitit ushtrimor, kësti mujor i paradhënies përcaktohet duke u mbështetur në masën e fitimit të tatueshëm të dy viteve më parë, siç është përshkruar në shembullin e mëposhtëm:

Shembull nr. 1

Tatimi mbi fitimin

 Viti 2010 = 1,200,000 lekë

 Viti 2011 = 1,800,000 lekë

Paradhëniet për vitin 2012:

Janar-prill 2012: 1,200,000/12 muaj = 100,000 lekë/muaj

100,000 x 4 muaj = 400,000 lekë në muaj

Maj-dhjetor 2012: 1,800,000 – 400,000/8 muaj = 175,000 lekë/muaj

175,000 x 8 muaj = 1,400,000 lekë për 8 muaj.

b) Në rastin kur tatimpaguesi ka më pak se dy vite që e ka filluar veprimtarinë, kështet e paradhënieve të tatimfitimit për periudhën ushtrimore llogariten sipas shembullit të mëposhtëm:

Shembull nr. 2

Tatimi mbi fitimin

 Viti 2010 (fillon aktivitetin më 1 prill) 900,000 lekë

 Viti 2011 = 1,800,000 lekë

Paradhëniet për vitin 2012

janar-prill 2012: 900,000/9 muaj = 100,000 lekë/muaj

100,000 x 4 muaj = 400,000 lekë në muaj

Maj-dhjetor 2012: 1,800,000 – 400,000/8 muaj = 175,000 lekë/muaj

c) Kur tatimpaguesi ka më pak se një vit që e ka filluar veprimtarinë, paradhëniet e tatimfitimit llogariten sipas shembullit të mëposhtëm:

Shembull nr. 3

Tatimi mbi fitimin

 Viti 2010, nuk ka aktivitet

 Viti 2011, fillon aktivitetin më 1 prill = 1,350,000 lekë

Paradhëniet për vitin 2012

janar-prill 2012: paradhënia sipas vlerësimit të tatimpaguesit

maj-dhjetor 2012 = 1,350,000 lekë/9 muaj = 150,000 lekë/muaj

150,000 x 8 muaj = 1,200,000 lekë

ç) Kur tatimpaguesi nuk ka paguar këstin e paradhënieve të tatimfitimit për muajin prill, paradhëniet e tatimfitimit llogariten sipas shembullit të mëposhtëm:

Shembull nr. 4

Tatimi mbi fitimin

 Viti 2010 = 1,200,000 lekë

 Viti 2011 = 1,800,000 lekë

Paradhëniet për vitin 2012

janar-prill 2012: 1,200,000/12 muaj = 100,000 lekë/muaj

100,000 x 4 muaj – 400,000 lekë në muaj

maj-dhjetor 2012 = 1,800,000 - 300,000/8 muaj = 187,500 lekë/muaj

187,500 x 8 muaj = 1,500,000 lekë për 8 muaj.”.

5. Tabela nr. 2 “Tatimi mbi kalimin e së drejtës së pasurisë së paluajtshme shfuqizohet”.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode